



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit - SP -  
Nr. Prot. Broj.Prot. Prot.No 60-2/26  
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages 03  
Data Datum. Date 15.09.26  
PRISHTINE/A

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

|                        |                                                                                                       |
|------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATE/A:                | 09.09.2026                                                                                            |
| REFERENC-Ë:            | 26/60/MMPH                                                                                            |
| PËR/ZA/TO:             | "Osman Z. Gashi" B.I. me emër tregtar N.T.P. "OTI"<br>Podujevë<br>Fermë e pulave në Letanc, Podujevë. |
| CC:                    | Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore                                               |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |                                                                                                       |
| NGA/OD/FROM:           | Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i<br>MMPH-së                                     |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Vendim për ndërprerje të procedurës administrative                                                    |

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 26/60/MMPH, datë 09.01.2026, të parashtruar nga operatori "Osman Z. Gashi" B.I. me emër tregtar N.T.P. "OTI" Podujevë, për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. ref. 4761/17/MEA, dt. 07.07.2020, për veprimtarinë: fermë e pulave në Letanc, Podujevë.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore për operatorin "Osman Z. Gashi" B.I. me emër tregtar N.T.P. "OTI" Podujevë, për veprimtarinë: fermë e pulave në Letanc, Podujevë.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/60/MMPH  
Datë: 09.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

## V E N D I M

Operatorit "Osman Z. Gashi" B.I. me emër tregtar N.T.P. "OTI" Podujevë, i ndërpritet procedura administrative për kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 26/60/MMPH, datë 09.01.2026, për veprimtarinë: fermë e pulave në ngastrat kadastrale: nr. 40-1, nr. 40-2, nr. 40-3, nr. 41-1, nr. 41-2 dhe nr. 576-2, zona kadastrale Letanc, Podujevë.

## A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore me nr. prot. 26/60/MMPH, datë: 09.01.2026, të operatorit "Osman Z. Gashi" B.I. me emër tregtar N.T.P. "OTI" Podujevë, për veprimtarinë: fermë e pulave në Letanc, Podujevë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka kontrolluar lëndën në bazë administrative dhe në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, me datë 10.07.2026 ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumentacionit shtesë si në vijim:

- Vendimin e Pëlqimit Mjedisor ne emër te kompanisë N.T.P. "OTI" Podujevë ne baze te cilës është lëshuar Leja mjedisore me nr. 4761/17 e lëshuar më dt. 14.07.2020;

- Ne rast se ka ndryshim te pronarit nga aj i cili posedon Pëlqim Mjedisor ne emër te N.T.P. "OTI" Podujeve atëherë na sjellni Transferin e Pëlqimit Mjedisor nga kompania N.T.P. "OTI" Podujeve te "Osman Z.Gashi" B.I., ne rast se nuk ka ndryshim te pronareve atëherë na sjellni një dëshmi nga ARBK se pronari është i njëjtë vetëm se ka ndërruar emri i firmës.

Operatori nuk ka sjellur dëshmi për plotësimin e dokumentacionit shtesë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur me datë 25.08.2026, konstatoi se operatori "Osman Z. Gashi" B.I. me emër tregtar N.T.P. "OTI" Podujevë, për veprimtarinë: fermë e pulave në Letanc, Podujevë, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrisë;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.